



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I RESTAURIMIT DHE TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS

Tiranë, më 25.01.2022

Lënda: Përcaktimi i kriterëve të pranimit të kandidatëve, të cilët do të aplikojnë në Programin e Ciklit të Dytë të Studimit MPRMK, për vitin akademik 2023-2024

VENDIM Nr. 1

Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, në mbledhjen e datës 25.01.2022, vendosi kriteret e pranimit, për kandidatët të cilët do të aplikojnë në Programin e Ciklit të Dytë të Studimit, Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024, si më poshtë vijon:

1. Kandidati, duhet të jetë diplomuar në Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, në Arkitekturë, ose në Programet e Studimit të Ciklit të Parë, dhe/ose të Ciklit të Dytë, në Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimit (Inxhinier Ndërtimi), duke i dhënë prioritet në regjistrim, kandidatëve të diplomuar në UPT, përkatësisht në:
 - Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës;
 - Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (Inxhinieri Ndërtimi);
2. Kandidatët, të cilët janë diplomuar jashtë vendit, në Programet e Studimit të përmendura më sipër, duhet të kenë kryer njësimin e Diplomës, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë, të shtetit Shqiptar.
3. Renditja e kandidatëve, do të bëhet, në rend zbritës, në bazë të mesatares më të lartë të notave, sipas kategorive të kuotave të miratuara.
4. Procedura e pranimit, do t'i përmbahet udhëzimeve të MASR dhe Rregullores së Programit të Ciklit të Dytë të Studimit, Master Profesional, në Restaurim Monumentesh Kulture.

Anëtarët e Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës:

Dr. Entela Daci Dr. Loreta Çapeli Dr. Etleva Bushati Dr. Endrit Tuzi

Dr. Marsida Tuxhari Dr. Jonida Mëniku MSc. Llazar Shyti MSc. Andronira Burda

**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE
URBANISTIKËS**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", Nr.54, Tiranë,
Tel/Fax: +355(4)2229045,
web: www.fau.edu.al